



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 77/6 prot.

Tiranë, 13.2.2019

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 90, datë 20.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Komisionit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijëni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datë 30.1.2019, është njoftuar vendimi nr. 90, datë 20.12.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit z. Adnand Kosova, prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

Ndaj këtij vendimi, në zbatim të nenit B, pika 3, germa “c<sup>1</sup>”, e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 65, pika 2<sup>2</sup>, e ligjit nr. 84/2016, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datë 1.2.2019, është depozituar akti “*Rekomandim për paraqitje ankimi*”,<sup>3</sup> nënshkruar nga tre vëzhgues ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, ndaj vendimit nr. 90, datë 20.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit z. Adnand Kosova.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

<sup>1</sup> Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit... c) u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim...

<sup>2</sup> Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë t’i paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik, për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

<sup>3</sup> Protokolluar në Institucionin e Komisionerëve Publikë me nr.77/3 prot., datë 1.2.2019.

Brenda afati ligjor, unë, Komisioneri Publik Darjel Sina, ushtroj ankim ndaj vendimit nr. 90, datë 20.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

## **I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

1. Zoti Adnand Kosova, aktualisht me detyrë prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme, u vlerësua nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar *Komisioni*) në zbatim të nenit 179/b, paragrafi 3 i Kushtetutës dhe në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 84/2016.

2. Procesi i rivlerësimit (zhvilluar gjatë periudhës 15.1.2018-19.12.2018), ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, *Komisioni* ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe raportin e vlerësimit profesional nga Grupi i Punës në Prokurorinë e Përgjithshme, nga të cilat rezulton se:

2.1 Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të "*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin z. Adnand Kosova,*"<sup>4</sup> ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar se:

- i. *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii. *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv. *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- v. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 **Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar**, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin, ka referuar "*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Adnand Kosova*".<sup>5</sup>

2.3 **Prokuroria e Përgjithshme** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

3. Komisioni, pas hetimit administrativ mbi kriteret e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale dhe vlerësimit të fakteve dhe rrethanave, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit, z. Adnand Kosova, ka plotësuar së bashku kushtet e parashikuara nga neni 59, pika 1 e ligjit 84/2016 dhe ka vendosur: "*Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Adnand Kosova, me funksion prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme*".

<sup>4</sup> Shkresa e ILDKPKI-së me nr. \*\*\*, datë \*\*\*.11.2017.

<sup>5</sup> Shkresa e DSIK-së me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.10.2017 (deklasifikuar plotësisht me shkresën nr. \*\*\*, datë \*\*\*.9.2018).

## II. Shkaqet e ankimit

4. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet që kryejnë procesin e rivlerësimit kalimtar (*Vetting*).
5. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar si: *Kolegji*).
6. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore, që u njihen *Komisionit* dhe *Kolegjit*, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës, nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të *Komisionit* ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e këtij të fundit, pa pasur mundësinë ai vetë (Komisioneri), që të ketë akses në burimet e informacionit dhe të disponojë për marrjen e provave.
7. Në të tilla rrethana ligjore, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit.
8. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, bazuar në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, nga shqyrtimi i vendimit nr. 90, datë 20.12.2018, dhe provave të administruara për këtë qëllim nga *Komisioni*, në konsideratë edhe të rekomandimit të ONM-së (bashkëlidhur këtij ankimi), vlerëson se vendimi përmban shkaqe të mjaftueshme për t'iu paraqitur juridiksionit rishikues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për vendimmarrje.
9. Mbështetur në kërkesat kushtetuese e ligjore të sipërcituara dhe vlerësimin e provave dhe fakteve të administruara nga hetimi administrativ i Komisionit, në rastin konkret ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 90, datë 20.12.2018, të Komisionit, ushtrohet për të tria kriteret, atë të kontrollit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, z. Adnand Kosova.
10. Komisioneri Publik beson se një vlerësim korrekt i provave të çështjes dhe zbatimi korrekt i kuadrit ligjor duhet të çojë në shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, z. Kosova.

### III. Vlerësimi i Komisionerit Publik

#### 11. Pasuria e paluajtshme, apartament banimi

Gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit, kontroll dhe vlerësim i *kriterit të pasurisë* për subjektet që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin dhe hetimin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve, kontrollin e pasurisë, ligjshmërisë së burimit të krijimit të saj dhe i përmbushjes së detyrimeve të ligjshme financiare.

**Në Deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar:** Apartament banimi në posedim, me sip. 98 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, pall. i Gjykatës së Apelit, pronotuar me kontratë porosie individuale të datës \*\*\*.2.1998, e pahipotekuar dhe futur në procesin e legalizimit. *Vlera* 19.600 USD (nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind). *Pjesa takuese:* e paspecifikuar. *Burimi i deklaruar i të ardhurave për banesën:* Kursime familjare nga (i) paga e subjektit dhe e bashkëshortes ndër vite, (ii) mësimdhënia si pedagog i jashtëm në Universitetin “Fan Noli” (iii) të ardhura nga shitja e apartamentit në Korçë, i përfituar nga ligji për privatizimin e banesave.

**Në Deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie, e vitit 2004 (deri më 31.12.2003), subjekti ka deklaruar:** Apartament banimi me sipërfaqe 100 m<sup>2</sup>, në adresën: rruga “\*\*\*\*”. *Vlera* 2.600.000 lekë. *Pjesa takuese* e paspecifikuar. *Burimi i krijimit:* nga shitja e apartamentit të banimit në Korçë, si dhe kursimet. *Banesa është shitur* 2.500.000 lekë.

**11.1 Në fashikull të Komisionit, ndër të tjera është administruar:** (i) Kontratë porosie individuale e datës \*\*\* shkurt 1998, me palë Adnand Kosova, *porositës* dhe firma ndërtuese “\*\*\*\* sh.p.k.”, *i porositori*. Kontrata është redaktuar jashtë zyrës së noterisë dhe vërtetohet konform ligjit nga noteri \*\*\*.\*\*\*, me vërtetimin me nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., e datës \*\*\* shkurt 1998; (ii) fotokopje mandat arketimi nr. \*\*\*, datë \*\*\*.2.1998; (iii) kontratë shitblerje, pasuri e paluajtshme, me nr.\*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., e datës \*\*\*.6.2002, e redaktuar para noterit \*\*\*.\*\*\*.\*\*\*, Zyra e Noterisë Korçë; (iv) shkresë nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.11.2018, e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, drejtuar Komisionit të Pavarur të Kualifikimit; (v) deklaratë noteriale e shtetasit \*\*\*.\*\*\*.\*\*\*, me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë \*\*\*.8.2018, mbajtur para noterit \*\*\*.\*\*\*, Dhoma e Noterisë Korçë; (vi) shkresë me nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.12.2018, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, drejtuar z. Adnand Kosova.

**11.2** Nga aktet në dosje rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Kosova, ka lidhur kontratën individuale të porosisë të datës \*\*\* shkurt 1998, për apartamentin me sipërfaqe 98 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në rrugën: “\*\*\*\*”, Tiranë, për çmimin prej 19.600 USD.

**11.3** Në Deklaratën e vitit 2003, subjekti i rivlerësimit, z. Kosova, deklaroi se për apartamentin 98 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në Tiranë, ka paguar vleftën *2.600.000 lekë (dy milionë e gjashtëqind mijë)*, të krijuara 2.500.000 lekë (dy milionë e pesëqind mijë) nga shitja e apartamentit në Korçë dhe kursime nga të ardhurat familjare. Vlefta e plotë është shlyer në periudhën kohore shkurt 1998 - mars 2000, ku respektivisht ka bërë pagesën 1.900.000 lekë, më datë \*\*\* shkurt 1998, dhe për pjesën e mbetur të shumës, 2.600.000 lekë, nuk deklaroi kohë kur ka ndodhur pagesa apo dokument që provon pagesën e saj.

**11.4** Për të justifikuar pagesën prej 1.900.000 lekë, e bërë më datë \*\*\*.2.1998, subjekti i rivlerësimit, z. Kosova, deklaroi se shumën prej 1.500.000 lekë, të marrë si kapar nga shtetasi

\*\*\*.\*\*\*, e ka përdorur për pagesën e këtij kësti. Fakti i *marrëdhënies së kaparit* ndërmjet subjektit të rivlerësimit, z. Kosova, dhe z. \*\*\* është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit gjatë procedurës së rivlerësimit dhe, si mjete provuese për këtë marrëdhënie kapari, subjekti i rivlerësimit mbështetet në (i) deklaratën vjetore të vitit 2003, ku përshkruan se apartamenti në Korçë është shitur për vlerën 2.500.000 lekë; (ii) deklaratën noteriale të shtetasit \*\*\*.\*\*\*. (blerësi), të datës \*\*\*.8.2018; (iii) shpjegimit të datës \*\*\*.9.2018 (*shihni pyetja 5*), se për këtë marrëdhënie si një veprim juridik jo i detyrueshëm për t'u bërë para noterit publik, është përpiluar një deklaratë dore, ku pasqyrohej veprimi i bërë dhe që aktualisht (viti 2018) nuk e disponon; (iv) shpjegimit të datës \*\*\* shtator 2018 (*shihni pyetja 2*), se çmimi real i shitjes së apartamentit në Korçë, sqarohet se është plotësisht i justifikueshëm referuar çmimit të tregut të kohës.

**11.5** Akt në dosjen e Komisionit, për shitblerjen e apartamentit në Korçë është kontrata e datës \*\*\*.6.2002, e redaktuar para noterit \*\*\*.\*\*\*, ku çmimi i vendosur është në vlef të 1.000.000 lekë, e shlyer jashtë zyrës noteriale, për të cilën subjekti i rivlerësimit, z. Kosova, në shpjegimet e datës \*\*\* shtator 2018 (*shihni pyetja 3*) sqaron rrethanat e lidhjes së kontratës para noterit. Sipas subjektit të rivlerësimit, z. Kosova, noterit i është sqaruar marrja e kaparit në vlerën prej 1.500.000 lekë dhe noteri ka sqaruar se ligji i kohës në vitin 1998 (muaji shkurt) nuk parashikonte tatim, në të tilla rrethana është vendosur shuma 1.000.000 lekë.

**11.6** Komisioni, lidhur me gjendjen faktike të përshkruar më sipër, konkludon se:

*Në përfundim të procesit të rivlerësimit të pasurisë, për subjektin e rivlerësimit, z. Adnand Kosova, trupi gjykues vlerëson se ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij, si dhe nuk rezultojnë të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij.*

*Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit arrin të justifikojë bindshëm pasuritë e tij, në kuptim të nenit D, pikat 1 e 3, të aneksit të Kushtetutës, si dhe ka treguar një qasje korrekte e të sinqertë në raport me deklarin e tij në deklaratën e pasurisë "Vetting", por në mënyrë të vazhdueshme edhe në deklaratat e pasurisë në vite, duke e çuar trupin gjykues në përfundimin se ai nuk ka fshehur dhe ka deklaruar në mënyrë të saktë pasurinë në vijimësi. Për këto arsye, trupi gjykues ka konkluduar se ai ka bërë deklarin të mjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë.*

*Pasaktësia e konstatuar në hartimin e kontratës së shitjes së pasurisë në Korçë, duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit dhe nuk cenon figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut të drejtësisë. Diferenca e konstatuar në analizën financiare të vitit 1998 nuk është në masën që cenon besimin e publikut, duke marrë në konsideratë se vetë natyra e analizës financiare është një instrument që mund të paraqesë një kufi të caktuar dhe mungesa e këtij likuiditeti në këtë masë<sup>6</sup>, nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit (faqe 14-15).*

**11.7** Në vlerësimin e Komisionit Publik, konkluzioni i mësipërm nuk përputhet me situatën faktike bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje të Komisionit, pasi rrethanat ligjore që paraqiten për këtë pasuri janë të tilla që çojnë në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, z. Kosova,

---

<sup>6</sup> Vendimi nr. 70, datë 16.10.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

(i) nuk arrin të shpjegojë bindshëm origjinën e ligjshme të burimit prej 1.500.000 lekë për blerjen e apartamentit 98 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*” Tiranë.

### **11.8 Lidhur me origjinën e ligjshme të shumës prej 1.500.000 lekë**

11.8.1. Komisioneri Publik, ashtu sikurse arsyetohet në Rekomandimin e ONM-së, rithekson dhe bashkohet me qëndrimin se, citoj: *“Pasuritë e z. Kosova të deklaruar në deklaratën Vetting duhet t’i nënshtrohen një kontrolli/vlerësimi të hollësishëm, për t’u siguruar që funksionari zyrtar është një person me integritet dhe të vendosë nëse e gjithë pasuria është e ligjshme. Nuk mund të përjashtohet nga kontrolli/vlerësimi i pasurive të krijuara para vitit 2003, të cilat, megjithatë, duhet të analizohen rast pas rasti në kuptim të vlerësimit të shpjegimit bindshëm dhe provat mbështetëse lidhur me origjinën e ligjshme. Për këtë arsye, një qasje fleksibël kërkohet për ngjarjet e ndodhura shumë vite më parë, por shpjegimet nuk duhet të jenë të paarsyeshme dhe /ose nuk mund të pranohen kur janë në kundërshtim me parashikimet ligjore të zbatueshme, të cilat kanë qenë në fuqi apo kur sjellje të caktuara, apo veprime ligjore janë kryer me qëllime mashtrimi”.*

11.8.2 Komisioneri Publik beson se **nuk provohet** me prova të besueshme ekzistenca e burimit prej 1.500.000 lekë, për blerjen e 98 m<sup>2</sup> të apartamentit në rrugën “\*\*\*\*”, në Tiranë (sikurse është deklaruar në deklaratën Vetting), e pretenduar si e prejardhur nga shitja e mëparshme e apartamentit në Korçë. Subjekti i rivlerësimit, z. Kosova, pohoi se çmimi i apartamentit të shitur në Korçë, për të cilin kishin rënë dakord me blerësin, z. \*\*\*.\*\*\*., ishte 2.500.000 lekë, nga të cilat 1.5 milionë lekë u morën si pagesë kapari nga z. \*\*\*.\*\*\* në shkurt 1998, në ko incidencë me kontratën individuale të porosisë, lidhur më \*\*\* shkurt 1998, me shoqërinë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., për apartamentin në Tiranë. Subjekti i rivlerësimit për të provuar pagesën e kaparit mbështetet në deklaratën e vitit 2003, ku deklaroi shitjen e apartamentit në qytetin e Korçës, në vlerën 2.500.000 lekë dhe deklaratën noteriale të datës \*\*\* gusht 2018, të shtetasit \*\*\*.\*\*\*, ku deklarohet kjo shumë.

11.8.3 Në zbatim të kriterëve që vendos neni 49, paragrafi 4 i ligjit nr. 84/2016, Komisioni ... e bazon vendimin vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Në rastin konkret, dokumentet ku mbështetet pretendimi i subjektit të rivlerësimit (DV-2003 e Deklarata Noteriale), nuk janë në pajtueshmëri me provën ligjore të kontratës së shitjes së apartamentit në qytetin e Korçës, të datës \*\*\*.6.2002. Deklarate vjetore 2003, në kuptim të nenit 32, pika 5 të ligjit, mund të përdoret si provë dhe duhet të gjejë harmoni dhe pajtueshmëri me provat e tjera, gjë e cila nuk ndodh në rastin konkret. Për sa i përket Deklaratës Noteriale të datës \*\*\*.8.2018, rezulton se është paraqitur pas dorëzimit të D-Vett., gjatë hetimit administrativ, dhe, si e tillë, ashtu sikurse edhe pretendimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, mbetet në nivelin deklarativ dhe nuk mund të konfirmojë, pa qenë në harmoni me prova realisht të tjera, provueshmërinë që faktet e deklaruara në to kanë ndodhur.

11.8.4 Për sa i përket anës formale të marrëdhënies së kaparit, parë kjo në lidhje me kontratën e shitjes së datës \*\*\*.6.2002, e lidhur katër vjet pas pretendimit të pagesës së kaparit, rezulton se në përmbajtje të saj nuk pasqyrohet si marrëdhënia e pretenduar e kaparit, ashtu edhe shuma 1.500.000 lekë, si pagesë e marrë nga subjekti i rivlerësimit, z. Kosova, në cilësinë e shitësit dhe dhënien e kësaj shume nga z. \*\*\*.\*\*\*, në cilësinë e blerësit. Këtë mungesë të pasqyrimin të këtyre të dhënave, subjekti i rivlerësimit, z. Kosova, e sqaron në përgjigjet e datës \*\*\* shtator 2018, ku shpjegon se rrethanat i janë treguar noteres dhe, pas një analize të zbatimit të legjislacionit tatimor, në përfundim është vendosur në kontratën e shitblerjes shuma 1.000.000 lekë.

## **11.9 Lidhur me shmangien e pagesës së tatimit për shumën 2.500.000 lekë**

*11.9.1* Nëse do të nisemi nga premisa se *marrëdhënia e kaparit* për shumën 1.500.000 lekë është e provuar tej çdo dyshimi, atëherë rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka paguar detyrimet tatimore për të ardhurat prej 2.500.000 lekë, të krijuara nga shitja e pasurisë së paluajtshme, apartament në qytetin e Korçës. Pretendimi se në vitin 1998 nuk ka pasur ligj për tatimin mbi të ardhurat nuk qëndron, pasi ligji ka ekzistuar, por fashat për të cilat zbatohet tatimi mbi të ardhurat kanë qenë të ndryshme. Gjithashtu është i gabuar vendosja në kohë e zbatimit të ligjit, pasi paradhënia si kapar, pa u realizuar kontrata e shitblerjes, nuk mund të quhet e ardhur për subjektin e rivlerësimit, z. Kosova. Komisioneri Publik në këtë version të rastit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka shmangur pagimin e detyrimit tatimor, duke deklaruar vetëm vlerën prej 1.000.000 lekë në kontratë, në një fazë të mëvonshme, për të cilën ka paguar detyrimin tatimor prej 5.000 lekësh, pra ka përjashtuar shumën prej 1.500.000 lekësh, të paguara paraprakisht si kapar.

## **11.10 Lidhur me pamundësinë financiare për pagesën e pretenduar në vleftën 1.900.000 lekë**

*11.10.1* Nga analiza financiare e të ardhurave dhe shpenzimeve të subjektit të rivlerësimit, paraqitur edhe në formë tabelare, duke marrë në përllogaritje të ardhurat e ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në vitin 1998, nuk ka pasur aftësi pagueuse për të justifikuar blerjen e pasurive të deklaruara. Megjithëse subjekti ka deklaruar si burim krijimi të këtij apartamenti dhe të ardhurat nga mësimdhënia në Universitetin “Fan Noli”, në Korçë, këto të dhëna nuk janë marrë në konsideratë, sepse janë konfirmuar me vlerë të përafërt nga institucioni dhe, gjithashtu, nuk kanë impakt në balancën negative. Nëse konsiderojmë shpenzimet e jetesës sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në shumën 814,712 lekë, atëherë kjo diferencë do të thellohej më tepër.

*11.10.2* Për sa i përket analogjisë së përdorur nga Komisioni se *...Diferenca e konstatuar në analizën financiare të vitit 1998 nuk është në masën që cenon besimin e publikut, duke marrë në konsideratë se vetë natyra e analizës financiare është një instrument që mund të paraqesë një kufi të caktuar dhe mungesa e këtij likuiditeti në këtë masë<sup>7</sup> nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit*”, sqarojmë se vendimi nr. 70/2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, shprehet se, citoj *“...mungesë likuiditetesh përgjatë viteve, pas analizës financiare të përditësuar...”*, pra nuk jemi para një rasti të ngjashëm, si për faktin që në këto vite subjekti i rivlerësimit i vendimit 70/2018 nuk ka shtuar pasuri, ashtu edhe shuma sipas viteve ishte me shifra që varionin gjatë 6 viteve dhe jo në një vit të vetëm, nga 16.000 – 270.000 lekë.

### *11.10.3 Metodologjia e kryerjes së analizës financiare:*

Gjatë analizës financiare të subjektit janë marrë në konsideratë të ardhurat e ligjshme, të cilat plotësojnë kriteret e nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, shpenzimet për jetesë të kryera nga subjekti dhe familja, blerja e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe kursimet e deklaruara gjendje *cash* dhe gjendjet në llogaritë bankare.

**12.** Referuar gjendjes së akteve mbi të cilat Komisioni mori vendimin për konfirmimin në detyrë të z. Adnand Kosova, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit, z. Adnand Kosova, nuk e justifikon burimin e ligjshëm për blerjen e këtij apartamenti, si dhe ka deklarim të pamjaftueshëm për kriterin

---

<sup>7</sup> Vendimi nr. 70, datë 16.10.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

e kontrollit të kësaj pasurie sipas nenit 61, pika 3, të ligjit 84/2016, dhe nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, sipas nenit D, pika 3, të aneksit të Kushtetutës.

**13.** Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë bindshëm<sup>8</sup> burimin e të ardhurave, duke u përpjekur të deklarojë në mënyrë të rremë apo duke anashkaluar parashikimet ligjore, me qëllim kryerjen e evazionit fiskal, në vlerësimin e Komisionerit Publik, referuar nenit E të aneksit të Kushtetutës, kreut VII të ligjit nr. 84/2016, vendimi i është i cenusshëm, pasi nuk i përgjigjet provave të administruara gjatë procesit të rivlerësimit.

**14.** Në rrethana të tilla është e qartë se dispozitat e nenit 59/1 të ligjit nuk janë të zbatueshme dhe neni 61, pika 3 dhe 5, duhet të aplikohet.

#### **IV. Kërkimi i ankimit**

**15.** Duke ritheksuar se Komisioneri Publik, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik në procesin e rivlerësimit, ka të drejtën dhe detyrimin e ushtrimit të kontrollit ndaj vendimeve të dhëna nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, duke vlerësuar nëse vendimmarrja bazohet në një hetim të plotë dhe të gjithanshëm, dhe çmim të drejtë të provave të administruara;

**16.** Në konsideratë të trajtimit të shkaqeve të ankimit, bazuar në parashikimet e nenit 179/b (5), të Kushtetutës, nenit C (2), Ç, D, E dhe F (7), të aneksit të Kushtetutës, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriterin e pasurisë, referuar gjendjes së fakteve dhe provave, Komisioneri Publik nuk krijon bindjen se për subjektin e rivlerësimit gjen zbatim neni 59/1 i ligjit nr. 84/2016;

**17.** Mbështetur në parashikimin e nenit F, pika 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, kërkohet që shkaqet e parashtruara në këtë ankim të merren në konsideratë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, pas hetimit të plotë për subjektin e rivlerësimit, z. Adnand Kosova, në përfundim të gjykimit të çështjes, në bazë të nenit 66, pika 1, germa “b” e ligjit 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 90, datë 20.12.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Adnand Kosova dhe shkarkimin e subjektit nga detyra.

### **KOMISIONERI PUBLIK**

#### **DARJEL SINA**

I bashkëlidhet këtij ankimi:

1. Rekomandimi nr. 92/2 prot., datë 1.2.2019, i ONM-së.
2. Opinioni i Vëzhguesit Ndërkombëtar nr. 92 prot., datë 28.1.2019, i ONM-së.

---

<sup>8</sup> Shihni nenin D, pika 3, të aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.